



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.AGJ.nr.1/2024-1

Me datë 19.01.2024

## KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### **RAPORTI PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE DHE DEGËVE TË SAJ NË DRAGASH DHE SUHAREKË PËR TRE MUJORIN E KATËRT-të ( TETOR - NËNTOR - DHJETOR 2023)**

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit për Gjykatat, paraqes reportin për tre majorin e katërt IV-të (tetor – nëntor - dhjetor 2023).

Raporti i Gjykatës për tremujorin e katërt është raport i cili është i veçantë për arsyen se kemi të bëjmë me përbylljen e vtitit dhe analizën e rezultateve të punës gjatë vitit 2023. Karakteristikë për këtë tremujor ka qenë pranimi i një numri enorm të padive që rrjedhin nga Kontrata Kolektive pas dy mendimeve të Gjykatës Supreme, (numri i padive të pranuara ka qenë 5369), riorganizim i punës në Divzionin Civil në lidhje me këto padi, riorganizimi punës dhe aktivitete të shtuara në barazimin e lëndëve fizike me lëndët në sistemin SMIL për të gjitha lëmi, kryerja e numrit më të madh të lëndëve civile gjatë vitit 2023 dhe në përgjithësi tremujori i katërt ka qenë tremujor me shumë punë dhe shumë rezultate.

Gjithashtu, në gjykatë është punuar intenzivisht në implementimin e projektit të USAID për instalimin e Audio dhe Video incizimeve nëpër salla të gjykimit i cili projekt planifikohet të përfundojë në muajin janar 2024. Puna e ekipeve punuese nga projekti nëpër salla, ka vështirësuar mbajtjen e gjykimeve dhe organizimin dhe koordinimin e këtyre gjykimeve të cilat kanë qenë të planifikuara nga ana e gjyqtarëve gjatë kohës kur janë kryer punimet.

Marrë në përgjithësi në aspektin e efikasiteti dhe zgjidhjes së lëndëve, Gjykata Themelore në Prizren ka një rritje të efikasitet të zgjidhjes së lëndëve në secilin departament dhe divizion, përashtimisht në 2 divizione (Kundërvajtjes dhe degën në Dragash). Tre mujori i IV-të, në krahasim në tre majorin e III-të, thuajse në secilin divizion ka rritje të efikasiteti dhe rritje të numrit të lëndëve të zgjidhura, kështu gjykata ka përbyllur vitin duke pasur rritje të efikasitet të zgjidhjes së lëndëve në secilin tre mujor, ndërsa vitin 2023, duke e përbyllur me një efikasitet më të lartë se viti 2022.

Tashmë Gjykata Themelore në Prizren pas një riorganizimi, ka një ritëm të punës që qon në trendë pozitive sa i përket rezultatit dhe efikasiteti dhe organizimit dhe shpërndarjes së punës.

Ndër të tjera, si Kryetare e gjykatës në ditë të caktuara organizojmë “*ditën e hapur*” dhe presim në takim qytetarët dhe palët e interesuara, shqetësimet dhe kërkesat e të cilëve i adresojmë dhe i trajtojmë me gjyqtarët dhe stafin mbështetës.

Në tre mujorin e IV-të rregullisht kemi pasur takime me gjyqtarët e divizioneve të caktuar, ndërsa me 26 dhjetor është mbajtur kolegjumi i rregullt me gjyqtarët. Në këtë kolegjum si rendi i ditës kanë qenë 1. Raporti i punës së viti 2023 dhe rezultatet e arritura, 2. Rezultatet e punës së gjyqtarëve gjatë vitit 2023 dhe nën 3. Plani i punës për vitin 2024. Pikat nga rendi i ditës janë diskutuar në tërësi me të gjithë gjyqtarët e secilit departament dhe divizion dhe është vendosur që do të mbahen edhe kolegjume të veçanta me secilin departament dhe divizion gjatë muajit Janar 2024 pasi që secili Departament dhe Divizion i ka specifikat e veta dhe duhet të shqyrtohen dhe të shtjellohen këto specifika në mënyrë më të detajuar.

### ***1. Përbushja e obligimeve që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025 dhe Plani strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të Korruptionit dhe Krimit të organizuar 2022-2024 dhe plotësimi i formularit për lëndët e korruptionit dhe krimin e organizuar – Trajtimi i lëndëve me prioritet?***

Referuar kësaj pike të diskutimit, ju njoftoj se gjatë tremujorit të IV-të-rë të vitit 2023, jemi në fazën ku jemi duke aplikuar dhe zbatuar planet Strategjike të KGJK-së, pasi që në periudhën 9 mujore 2023, është identifikuar dhe përpiluar raporte të veçanta për lëndët që bien në kompetencë të Planeve Strategjike.

Me gjyqtarët e secilit divizion kemi pasur takime të veçanta ku kemi identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë nga Planet Strategjike.

Nga secili gjyqtar kemi pranuar raport për lëndët që kanë në punë, duke i ‘u referuar kërkesave dhe detyrave që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Tashmë kemi identifikuar të gjitha lëndët në zyrën e secilit gjyqtar (Civile, Penale dhe Krimi të Rënda), të cilat do të kenë fokus të veçantë në trajtimin e tyre konform detyrave nga Planet Strategjike.

Sa i përket plotësimit të formularit sipas për lëndët e korruptionit dhe krimit të organizuar të njëjtën e plotësojmë dhe përditësojmë sipas kërkesës së Komisionit. Gjatë këtij tremujori nuk ka pasur kërkesë të veçantë për plotësim, por kemi plotësuar Formularin sipas kërkesës së KGJK për raport vjetor për lëndët e Korruptionit dhe Krimit të organizuar.

### ***Performanca e Gjykatës – Departamenteve dhe Divizioneve e shprehur në normë efikasiteti në %***

Në tremujorin e IV-të të vitit 2023, në tërësi si gjykatë kemi rezultuar me rritje të efikasitetit, në bazë të përqindjeve në lëndët e pranuar dhe atyre të zgjidhura.

E shprehur dha paraqitur në % norma e efikasiteti është si në vijim:

## Gjykata Themelore Prizren

### PENALE

D. për Krime të Rënda — Norma e zgjidhjes së lëndëve 70% (28 lëndë të zgjidhura)  
(143 aktive/në punë)

D. për të Mitur - Norma e zgjidhjes së lëndëve 271 % (65 lëndë të zgjidhura).  
(43 aktive/në punë)

Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve 118 % ( 495 lëndë të zgjidhura).  
(2,308 aktive/në punë)

### CIVILE

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 89 %  
Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 72 %. (1,649 Lëndë të zgjidhura)  
Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 245 % (235 lëndë të zgjidhura)  
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 109 % (338 Lëndë të zgjidhura)  
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 127 % (589 Lëndë të zgjidhura).

### AKTIVE / NË PUNË

KONTESTIMORE – 8,951 lëndë  
JO KONTESTIMORE – 678 lëndë  
PËRMBARIMORE – 1,701 lëndë  
KUNDËRVAJTJE – 2,034  
TOTALI: 13,365 lëndë

Pos në Departamentin për Krime të Rënda, që ka një rënie në efikasitet %, ka rritje të zgjidhjes së rasteve në Departamentin për të Mitur dhe Divisionin Penal.

Ndërsa në Divisionin Civil ka një rritje të efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve, sidomos lëndët përmbarimore ku qytetarët presin drejtpërdrejt realizimin e një të drejte, pasi që numri i lëndëve aktive ka rënë ndjeshëm, tashmë në 230 lëndë aktive.

Kjo është rezultat i angazhimit të të gjithë gjuqtarëve në këtë divizion dhe rritjes së numri të bashkëpunëtoreve.

*Referuar lëndëve përmbarimore, nuk përputhen të dhënat e përgjithshme me të dhënat individuale të gjuqtarit.*

Sipas Raporti të përgjithshëm të gjukatës, figurojnë 1,701 lëndë përmbarimore në pritje. Ndërsa gjuqtarit Sami Gashi sipas raportit për gjuqtarë, nuk i figuron ky numër i lëndëve.

Kjo mos përputhje në SMIL, figuron negativisht në të dhënat e përgjithshme për lëndët në pritje për gjukatën.

E njëjtë situatë shfaqet edhe në Divisionin e Kundërvajtjes, pra nuk përputhet numri i lëndëve aktive me të dhënat në SMIL dhe me gjendjen e lëndëve që kanë gjuqtarët në zyre.

Për më tepër bashkëngjitur keni tabelat e ndara në mënyrë specifike trajtimin e lëndëve sipas natyrës.

### Gjykata Themelore - Dega në Suharekë

Aktualisht në këtë gjykatë janë 4 gjyqtarë, dy në lëmine civile dhe dy në lëmine penale, kurse për lëndët e divizonit të kundërvajtjes që nga Janari i 2023 këto lëndë i trajtojnë gjyqtarët e Divisionit Penal, ndërsa janë deleguar edhe dy gjyqtarë të tjerë, të cilët janë në fazën përfundimtare të vitit të I-rë të punës dhe besojmë që me 6 gjyqtarë, gjatë vitit 2024 do të ketë rënie të numrit të lëndëve aktive, sidomos në Divisionin Civil.

Efikasiteti i shprehur në %.

### Gjykata Themelore – Dega SUHAREKË

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 136%  
Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 117% ( 476 Lëndë të zgjidhura)  
JoKontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 42% ( 42 lëndë të zgjidhura)  
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 142% ( 129 Lëndë të zgjidhura)  
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 206% ( 259 Lëndë të zgjidhura).

#### AKTIVE / NË PUNË

KONTESTIMORE – 3,074 lëndë

JO KONTESTIMORE – 99 lëndë

PËRMBARIMROE – 1,390 lëndë

KUNDËRVAJTJE – 831

TOTALI: 5,394 lëndë

#### PENALE

Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve 106% (112 lëndë të zgjidhura)  
(505 aktive/në punë)

Në tremujorin e IV-të. kjo Gjykatë ka treguar rritje të efikasitet të zgjidhjes së lëndëve në krahasim me tremujorët e tjerë të vitit, sidomos në Divisionin Civil lëndë kontestimore rritje të efikasitet nga 55 % në 117 %, dhe ka rënie të numrit të lëndëve aktive.

Me rritjen e numrit të Gjyqtarëve në 6, edhe me rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional në pesë (5) (nga dy (2) bashkëpunëtor sa ka qenë më herët), synohet që deri në qershor të vitit 2024, të ketë një punë efikase, dhe nga 1,500 lëndë për Gjyqtarë ky numër të bie rrëth 900 lëndë për Gjyqtarë.

Duke marrë parasysh numrin e Gjyqtarëve ku gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) Gjyqtarë, dhe stafin administrativ, kjo Gjykatë tregon një efikasitet të lartë dhe një organizim shembullor të punës dhe ndarjes së barabartë të punës dhe lëndëve, mirëpo në normë efikasiteti në

formë statistikore nuk shfaqet gjendja reale kjo për shkak të numrit të madh të lëndëve në ardhje, përkundër faktit që është Degë e Gjykatës mbulon një territor dhe Komunë me numër të lartë të banorëve.

Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj gjykate Selajdin Gallapeni pret në takim palët dhe personat e interesuar, ku ankesat dhe kërkesat e të cilëve i adreson te gjyqtarët.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë përballet me mungesë të stafit administrativ, referentë, roje sigurimi dorëzues, dhe pozita të tjera të cilat shfaqin pengesa në arritjen e synimeve dhe përm bushjen e të gjitha detyrave me kohë.

### **Gjykata Themelore - Dega në Dragash**

Në këtë gjykatë funksionojnë gjyqtari mbikëqyrës i cili njëkohësisht punon edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, kurse në degën në Dragash është i angazhuar në divisionin penal si dhe një gjyqtare e cila është e angazhuar në të gjitha lëmitë dhe një gjyqtar ndihmës nga Gjykata Themelore në Prizren, i angazhuar në Divisionin e Kundërvajtjes.

Efikasitet i shprehur në %.

#### **Gjykata Themelore – Dega DRAGASH**

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 173%

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 55% ( 35 Lëndë të zgjidhura)

Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 92% ( 11 lëndë të zgjidhura)

Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 255% ( 224 Lëndë të zgjidhura)

Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 242% ( 46 Lëndë të zgjidhura).

#### **AKTIVE / NË PUNË**

KONTESTIMORE – 1,254 lëndë

Jo KONTESTIMORE – 79 lëndë

PËRMBARIMROE - 278 lëndë

KUNDËRVAJTJE – 85

TOTALI: 1,696 lëndë

#### **PENALE**

Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve 77% (15 lëndë të zgjidhura)  
(308 aktive/në punë)

Në këtë Gjykatë ka rënie të numrit të lëndëve aktive në lëmine Përmbarimore dhe në Division për Kundërvajtje.

Raportet për vjetërsinë e lëndëve në pritje dhe raporte tjera i kemi paraqitur në raportin vjetor për vitin 2023.

Për më tepër bashkëngjitur gjeni raporte në tabelë të veçanta.

## ***2. Raportim për publikim të vendimeve;***

Publikimi i vendimeve gjyqësore tashmë një detyre dhe obligimi ligjor, të cilin Gjykata Themelore në Prizren e përbush në harmoni me Udhëzimet Administrative.

Gjatë periudhës Tetor – Nëntor - Dhjetor, janë publikuar 1,680 vendime gjyqësore.

Gjykata Themelore – Dega në Dragash, 75 vendime.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë 72 vendime.

Mesatarisht Gjykata Themelore në Prizren publikon ndërmjet 350-450 vendime në muaj, varësisht nga efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve.

Lidhur me këtë, ne kemi shikuar dhe vlerësuar raportin e Lëvizjes FOL dhe ashtu sikurse në të kaluarën do të marrim parasysh komentet dhe vlerësimet e tyre.

Përpos vendimeve për rastet që trajtohen, gjykata vazhdon ti publikoj brenda afatit ligjor edhe vendimet për rastet disiplinore që trajtohen nga Autoriteti Kompetent.

Gjykata gjatë vitit 2023 në çdo tremujor ka pasur rritje të numrit të vendimeve të publikuara, kjo duke organizuar dhe duke shpërndarë punën në mënyrë të barabarte edhe pse procesi i shkarkimit të vendimeve nga sistemi, anonimizimit, konvertimi dhe publikimi përfundimtar kërkon shumë persona dhe shumë punë mekanike, merr edhe kohë, mirëpo kjo tashmë është një obligim ligjor, që ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në besimin e publikut, dhe ka rënë numri i kërkesave për vendime, pasi që palët dhe organizata që përcjellin punën e gjykatës tashmë këto vendime i sigurojnë përmes web faqes së gjykatës.

Marrë në përgjithësi, në bazë të të dhënave nga numri i lëndëve të zgjidhura, përjashtimisht vendimet që nuk publikohen sipas udhëzimeve administrative, Gjykata Themelore në Prizren publikon të gjitha vendimet tjera që janë për tu publikuar, nga të gjitha Departamentet dhe Divisionet, duke respektuar 100% Udhëzimet Administrative për publikimin e vendimeve Gjyqësore, pasi që kujdesemi që të mos publikojmë vetëm si numër por të kemi kujdes edhe në cilësinë e mënyrë së publikimit të vendimeve.

## ***3. Angazhimi i Bashkëpunëtorëve Profesional***

Që nga vitit 2022, si Kryetare e gjykatës, në bashkëpunim me gjyqtarët, kemi bërë shpërndarjen e bashkëpunëtorëve profesional për secilin Gjyqtar, nga një bashkëpunëtor ose një bashkëpunëtor për dy gjyqtar. Në këtë tremujor duke pasur parasysh se kemi rritjen e lëndëve në divisionin civil kemi bërë një riorganizim të veçantë sa i përket ndarjes së bashkëpunëtorëve , respektivisht është formuar një zyre me tre bashkëpunëtor profesional të cilët kanë punuar me të gjithë gjyqtarët sipas padive të cila kanë ardhur nga Kontrata Kolektive, kurse bashkëpunëtorët tjerë si në divisionin civil si në atë penal kanë punuar me punë të tjera me të cilat janë ngarkuar nga ana e gjyqtarëve. Synojmë që në vitin 2024 të plotësohet numri i bashkëpunëtorëve dhe do të fuqizohet fillimisht divizioni civil me nga një bashkëpunëtor një gjyqtar dhe eventualisht do të

bëhet një riorganizim më i mirë në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira dhe të ketë rritje të efikasitetit të punës

Gjykata Themelore në Prizren, së bashku me degët Suharekë & Dragash, ka një numër prej 25 Bashkëpunëtorësh Profesional për një numër prej 33 Gjyqtarët, shpresojmë që ky numër do të rritet gjatë vitit 2024.

#### ***4. Referimi i rasteve gjyqësore në ndërmjetësim;***

Referuar rasteve të ndërmjetësimit në tremujorin e IV-të, janë si në vijim:

Tetor-Penale 18 të zgjidhura ,Civile 9 të zgjidhura, 3 të pazgjidhura,

Gjithsej 30 raste të trajtuara

Nëntor-Penale 19 të zgjidhura, Civile 3 të zgjidhura, 1 e pazgjidhur,

Gjithsej 29 raste të trajtuara

Dhjetor-Penale 23 të zgjidhura, Civile 10 të zgjidhura, 3 të pazgjidhura

Gjithsej 36 raste të trajtuara

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtore profesionale si referente për ndërmjetësim, dhe një praktikant i angazhuar nga USAID, që ndihmon për trajtimin e rasteve të referuar në ndërmjetësim.

Në gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

Gjithashtu jemi duke planifikuar, por që ende nuk është vendosur që edhe në gjykatën Themelore – Dega në Suharekë të krijojmë një hapësirë të veçantë dhe të caktojmë një zyrtar për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim. Kjo do të jetë si prioritet gjatë vitit 2024.

#### ***5. Ekzekutimi i dënimeve në procedurën civile dhe penale;***

Kryetarja e Gjykatës ka nën mbikëqyrje direkte ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe efikasiteti i këtyre zyrave është mbi 100%. Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ekzekutimet civile, në vazhdimësi paraqesin raporte tre mujore për punën dhe aktivitete tek Kryetarja e gjykatës dhe këto raporte bashkëngjiten në raporte tre mujore të rregullta që raportohen në KGJK të cilat janë miratuarë në mbledhjet e KGJK-së. Në muajt nëntor dhe dhjetor, është punuar intenzivisht për barazimin e lëndëve dhe mylljen e lëndëve edhe në SMIL

**Gjykata Themelore Prizren**

**Dëнимi me Burgim**

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale gjatë tremujorit të IV-të, ka ekzekutuar 25 lëndë të dënimeve me burgim, është parashkruar një (1) lëndë.

Ndërsa gjatë gjithë vitit 2023, janë ekzekutuar gjithsej 114 lëndë të dënimeve me burgim, 4 lëndë janë parashkruar, kurse kanë mbetur 71 lëndë aktive.

#### **Dënime me Gjobë**

Gjatë tremujorit të IV-të, janë ekzekutuar 163 dënime me gjobë, në 24 lëndë dënimis me gjobë është ekzekutuar me burgim. Gjatë kësaj periudhe është parashkruar një (1) lëndë.

Ndërsa gjatë gjithë vitit 2023, janë ekzekutuar 665 dënime me gjobë, në 121 lëndë dënimis me gjobë është ekzekutuar me burgim. Gjatë gjithë vitit 2023 janë parashkruar 17 lëndë.

#### **Ekzekutime Civile**

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve civile gjatë tremujorit të IV-të, ka kryer gjithsej 428 lëndë. Në këtë zyre janë të angazhuar tre (3) zyrtar.

#### **Gjykata Themelore – Dega në Suharekë**

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale në Suharekë gjatë tremujori të IV-të, ka kryer lëndët si në vijim: 51 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me gjobë, 120 lëndë të kryera – shpenzime të paushallit gjyqësor, një (1) lëndë e kryer me dënim me burgim, 12 lëndë aktive.

Ndërsa gjatë gjithë vitit 2023, janë 24 lëndë aktive të dënimeve me burgim, 174 lëndë të dënimeve me gjobë.

#### **Gjykata themelore – dega në Dragash**

#### **Dënime me burgim**

Gjatë gjithë vitit 2023 në këtë degë të gjykatës kanë qenë në trajtim 4 lëndë të dënimit me burgim, një (1) lëndë është parashkruar gjatë këtij viti.

#### **Dënime me Gjobë**

Gjatë tremujorit të IV-të, janë ekzekutuar 6 dënime me gjobë.

Kurse gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar 19 lëndë të dënimeve me gjobë. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 70 lëndë aktive.

#### **Ekzekutime Civile**

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024 në degën në Dragash janë zgjidhur 275 lëndë të paushallit gjyqësor, ndërsa gjatë tërë vitit 2023 janë zgjidhur 311 lëndë dhe kanë mbetur aktive 625 lëndë.

### **6. Trajtimi i rasteve të shënjestrurara**

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është në punë një rast (SHKOLLA), për një pikë të aktakuzës për një të akuzuar (në fillim kanë qenë 3 të akuzuar për disa pika të aktakuzës).

Kjo lëndë nga Departamenti i Krimeve të Rënda, është baruar në Departamentin e Përgjithshëm për shkak të kompetencës sa i përket natyrës së veprës penale për të cilën rasti është kthyer në rivendosje.

Gjithashtu, tashmë është regjistruar në sistemet SMIL dhe i është ndarë në punë gjyqtares një lëndë e kthyer në rigjykim për një pikë të aktakuzës, rasti "KRISTAL", i cili është trajtuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Ashtu që në vitin 2023 kemi dy raste aktive të shënjestruara,

**Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren**

**Shpresa EMRA**

